



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 20 prill filloi dëshminë dëshmitari i tretë në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*. Për shkak të masave mbrojtëse, dëshmia u dha në seancë të mbyllur.

Lidhur me këtë, duhet përmendur se të gjitha gjykimet në DHSK janë publike; megjithatë ndonjëherë gjykatësit vendosin ta kryejnë një pjesë të seancës së gjykimet në atë që quhet seancë private ose e mbyllur, ose të redaktojnë informacione të caktuara për të mbrojtur identitetin dhe sigurinë e dëshmitarëve ose të viktimave, sikurse përcaktohet në Rregullore. Edhe kur dëshmia e dëshmitarit nuk dëgjohej nga publiku, të akuzuarit dhe avokatët e tyre e dëgjojnë çfarë thotë dëshmitari dhe kanë të drejtën t'i bëjnë pyetje.

Paraqitja e provave nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në këtë çështje do të rifillojë të mërkurën, më 10 maj, në orën 9.00.

Më 21 prill, Pjetër Shala dorëzoi versionin publik të redaktuar të dosjes paraprake të tij.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për ditën e hënë, 1 maj, në orën 9.30. Seancat në këtë çështje do të vazhdojnë gjithë javën, nga 1 deri në 5 maj.

Më 24 prill, një vendim i datës 10 mars që më parë ishte konfidencial, për miratimin e një vizite të z. Gucati në Kosovë për arsye humanitare bindëse, u riklasifikua si publik. Vendimi kishte të bënte me vizitën e fundit të z. Gucati në Kosovë, më 15 mars 2023. Po kështu, sapo u bë publik edhe një parashtrim lidhur me një kërkesë për lirim me kusht të paraqitur nga z. Haradinaj, si edhe një vendim në të cilin informohet se kërkesa më vonë u tërhoq.

Në lajme të tjera: gjatë gjithë javës, disa parashtrime që më parë ishin protokolluar si konfidenciale, u bënë publike në bazë të një vendimi të Gjykatësit të Vetëm. Sipas njërit prej këtyre dokumenteve, më 20 janar 2020, Gjykatësi i Vetëm miratoi një kërkesë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) që një proces gjyqësor që po zhvillohej në një gjykatë të Kosovës të transferohej në DHSK. Megjithatë, pas hetimeve të kryera nga ZPS-ja, më 15 shtator 2022, ajo e njoftoi Gjykatësin e Vetëm se kishte vendosur ta mbyllte çështjen dhe të mos paraqiste aktakuzë për konfirmim.

Në lidhje me këtë duhet përmendur se, para se aktakuza të konfirmohet dhe të bëhet publike, procedurat para DHSK-së janë konfidenciale. Tani që procedurat janë mbyllur, dokumentacioni i gjykatës u bë publik me vendim të Gjykatësit të Vetëm. Gjithsesi, Gjykatësi i Vetëm mund të redaktojë informacione të caktuara për të mbrojtur privatësinë e personit në fjalë, ose për të mbrojtur viktimat ose dëshmitarët apo familjet e tyre.

Sipas Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë përparësi ndaj të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë për çështjet që përfshihen në juridiksionin lëndor të tyre. Në urdhrin për transferimin e një çështjeje gjyqësore mund të përfshihet kërkesa që çështja t'i transmetohet DHSK-së ose ZPS-së, sipas rastit.

Pyetje nga gazetarët

1

